

# KPK shkarkon prokuroren e Apelit të Korçës Rozeta Qirjaqi

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njoftoi shkarkimin nga detyra të prokurores së Apelit të Korçës Rozeta Qirjaqi.

Autor: [Vladimir Karaj](#) | BIRN | Tiranë



Prokuroreja e Apelit të Korçës Rozeta Qirjaqi pas vendimit të KPK. Foto:Vladimir Karaj

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njoftoi të mërkurën shkarkimin nga detyra të prokurores së Apelit të Korçës Rozeta Qirjaqi.

Trupi i kryesuar nga Etleda Çiftja, Roland Ilia relator dhe Firdes Shuli anëtare vendosi shkarkimin e prokurores, pasi gjatë hetimit u konstatua deklarim i pamjaftueshëm i pasurisë. Në seancën dëgjimore të 30 qershorit Qirjaqi, e cila u hetua në të tre kriteret, iu vunë në dukje disa probleme të pasurisë.

Kryesisht ajo u ndëshkua nga mungesa e dokumentacionit të të ardhurave të fituara nga i shoqi në emigracion në Greqi në vitet 1991-1999, rreth 7.7 milion lekë.

Rozeta Qirjaqi e ka filluar karrierën në sistemin e drejtësisë në fillim të viteve '90 dhe ka punuar si prokurore në Prokurorinë e Korçës. Në vitin 2008, ajo është emëruar prokurore në Apelin e Korçës, detyrë që e kryente deri sëfundmi.



RRETH AUTORIT

**Vladimir Karaj**

Vladimir Karaj është redaktor i Rrjetit Ballkanik për Gazetari Investigative në Shqipëri, BIRN Albania.